

VENDIM
Nr.718, datë 20.10.2011

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR,
UNAZA E MADHE E TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Unaza e Madhe e Tiranës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 16 978 (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë) m², me vlerë 44 519 117.37 (dyzet e katër milionë e pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekë, dhe për objekte, me vlerë 24 323 494 (njëzet e katër milionë e treqind e njëzet e tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e katër) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 68 842 611.37 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 68 842 611.37 (gjashtëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë pikë tridhjetë e shtatë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2011 “zëri investime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.10.2011 dhe të përfundojë më 30.12.2011.

7. Pronarët e objekteve të ndodhura në zonën kadastrale 8270, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Kufizohet deri në rregullimin e marrëdhënieve me truallin””, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të jetë hequr kufizimi përkatës, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Për objektet e ndodhura në zonën kadastrale 8280, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Zona në procesin e futjes në sistem/kufizim””, pronarët përkatës të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i futjes së zonës në sistem, heqjes së kufizimit përkatës, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Për objektet, të cilat janë në proces legalizimi, pronarët përkatës të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i legalizimit, i regjistrimit pranë ZVRPP-së, Tiranë, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

10. Pronarët e pasurive, tokë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, për pronarët e objekteve të ndodhura në zonën kadastrale 8280, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Zona në procesin e futjes në sistem/kufizim””, pasi të përfundojë procesi i futjes në sistem i kësaj zone dhe pasi të hiqet kufizimi përkatës, fakt i cili do të konfirmohet zyrtarisht nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, së bashku me titujt e pronësisë, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar, që do të dorëzojnë pronarët.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, për pronarët e objekteve të ndodhura në zonën kadastrale 8270, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja “Kufizohet deri në rregullimin e marrëdhënieve me truallin””, pasi të jetë hequr kufizimi përkatës, fakt i cili të konfirmohet zyrtarisht nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, së bashku me titujt e pronësisë, si dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar, që do të dorëzojnë pronarët.

13. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve të likuidojë pronarët e pasurive, tokë, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja” dhe pronarët e “objekteve në proces legalizimi”, sipas pikave 9 dhe 10 të këtij vendimi.

14. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

15. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

16. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha